



Kursi i nivelit **bachelor** përbëhet nga lëndët obligative dhe lëndët zgjedhore, të cilat kanë numrin e caktuar të ECTS kredive.



Planprogramet e propozuara janë të përmbledhura nga praktikat më të mira të disa Universiteteve rajonale dhe Evropiane si dhe me përvojën e gjatë të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".

Inxhinierët e prodhimit dhe automatizmit kryesisht mund të punojnë në incizimin, organizimin, analizën, planifikimin, mirëmbajtjen e makinave dhe të prodhimit në procesin teknologjik si dhe në disiplinat tjera fundamentale nga lëmi i inxhinierisë së prodhimit dhe të automatizmit në nivel të trendeve dhe zhvillimeve bashkëkohore.

Me këtë Inxhinieri mund të përgatis dokumentacionin tekniko-teknologjik dhe të njëjtin ta përcjell në vendin e duhur dhe me te ta kontrolloj procesin e prodhimit si për nga sasia ashtu edhe për nga kualiteti. Po ashtu përfiton njohuri të mjaftueshme për elementet bazë të proceseve automatike.

Të nderuar studentë të ardhshëm, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike është institucion i cili ka për qëllim zhvillimin dhe prosperimin e ekonomisë së Kosovës. Bëhuni pjesë e këtij institucioni. Të gjitha drejtimet e këtij Fakulteti janë atraktive dhe tërheqëse. Mos hezitoni të na vizitoni dhe të interesoheni.

Për më shumë informata në lidhje me Programin e Konstruktimit dhe Mekanizimit, procesin mësimor, lëndët që mësohen, përmbajtjen e lëndëve në të gjitha nivelet dhe informata tjera, ju lutem na vizitoni në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, ndërtesa e Fakultetit Teknik në Prishtinë, në nr. Tel. 038 - 552 - 126, ose në <http://fim.uni-pr.edu>.



Ndërtesa e Fakultetit Teknik ku ndodhet Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"

FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE

Programi:

PRODHTARI DHE AUTOMATIZIM



*Për prodhuesit e rinjë
drejt zhvillimit të Kosovës*

Kjo broshurë i dedikohet nxënësve të Shkollave të Mesme të interesuar për të studiuar Programin
Prodhtari dhe automatizim

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike mbush 55 vite pune dhe aktiviteti shumë të rëndësishëm në aftësimin e kuadrove të reja nga lëmitë makinerike, në hulumtimet shkencore dhe mësimore, në bashkëpunimin me ndërmarrjet inxhinierike dhe industriale dhe me institucionet shtetërore dhe publike.

Gjatë kësaj kohe Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike ka mëse 1800 inxhinierë dhe bachelor të diplomuar, mbi 200 magjistra të shkencave dhe të dretjimit master dhe një numër të konsiderueshëm të doktorëve të shkencave.

Stafi akademik është i kualifikuar dhe përbëhet nga 26 profesorë dhe ligjërues, 12 asistentë, 3 laborantë, 25 të angazhuar në punë plotësuese, dhe administrata me 8 të punësuar.

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike aktualisht është i ndarë në 6 programet mësimore

- **Prodhimtari dhe Automatizim,**
- **Termoenergjetikë dhe energji të ripërtitshme,**
- **Konstruksione dhe mekanizim,**
- **Komunikacion dhe transport,**
- **Mekatronikë,**
- **Inxhinieria Industriale dhe Menaxhmenti.**

Studimet organizohen në nivelin bachelor dhe master. Mësimi realizohet në formë të ligjëratave, ushtrimeve numerike, ushtrimeve laboratorike, vizita mësimore në terren, hulumtime, seminare, etj.

Fakulteti posedon salla të mësimit të standardeve të larta, salla kompjuterike, 8 labore për realizimin e ushtrimeve laboratorike dhe hulumtimeve shkencore, bibliotekën me lidhje të Internetit, etj.



Programi: **PRODHIMTARI DHE AUTOMATIZIM**

Prodhimtaria dhe automatizimi si një proces shumë i rëndësishëm shoqëror është i lidhur ngushtë me prodhimin e produkteve të ndryshme duke filluar nga ato ushqimore e deri te prodhimet e ndryshme teknike, ku i tërë ky proces i prodhimit në ditët e sotme të industrializimit është diku pjesërisht e diku i tërë i automatizuar.



Përmbajtja programore në studimet Bachelor u mundëson studentëve të fitojnë një bazë të zgjeruar të njohurive inxhinierike, aftësi dhe përvojë të mjaftueshme për punë individuale dhe kolektive gjatë zgjidhjes së problemeve konkrete në praktikë nga lëmi i prodhimitarisë dhe automatizimit, si dhe u mundëson bazë adekuate për vazhdimin e studimeve të mëtejshme.

Pas përfundimit me sukses të studimeve themelore Bachelor studenti do të jetë në gjendje të:

- Bëjnë incizimin dhe analizën e prodhimit në procesin e përpunimit të prodhimeve ushqimore, jometaleve dhe metaleve,
- Kalkulimin dhe procesin teknologjik të detaleve që përpunohen në makina metal përpunuese,
- Analizën dhe sintezën e automateve kombinuere se sekuanciale asinkrone të nivelit fillestar,
- Njohjen e sistemeve pneumatike dhe hidraulike dhe përcjelljen në proceset prodhuese.,
- Njohjen e algjebrën logjike për sintezën e automateve,
- Bëjnë njohjen dhe kontrollimin e materialeve të salduara dhe të josalduara,
- Bëjnë njohjen e instrumenteve dhe veglave për stancim dhe lakim,
- Përzgjedh metodat adekuate për analizën dhe sintezën e automateve sekuenciale,
- Bëjnë krahasimin e propozimeve të ndryshme me rastin e zgjidhjes së një problemi.

